

## NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për Planin Vendor i Arsimit Parauniversitar, 2026-2028.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë Z. Besmir Veli.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara te Bashkisë Delvinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me Planin Vendor i Arsimit Parauniversitar, 2026-2028.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në Bashkinë Delvinë, sipas kalendarit më poshtë:

	Data	Ora	Vendi
Delvinë	06.08.2025	11.00	Salla e keshillit bashkiak

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura, në adresat e emaileve: [irenabello@gmail.com](mailto:irenabello@gmail.com) dhe [keshillibashkiakdelvine@gmail.com](mailto:keshillibashkiakdelvine@gmail.com)

Linku i dokumentit: <https://www.bashkiadelvine.gov.al/projekt-akte-te-hapura-per-konsultim/>

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, administrata e bashkisë
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Delvinë, organizata joqeveritare, shoqëri civile dhe grupe interesi.

Forma e konsultimit: Takim publik.

Qëllimi i këshillimit publik	Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve sa i takon Planit Vendor i Arsimit Parauniversitar për 2026-2028.
Përshkrimi i çështjes	<p>Në territorin e Bashkisë Delvinë, për vitet në fjalë janë parashikuar të përfshihen 133 fëmijë në kopshte dhe 617 nxënës në shkolla, çka përbën një total prej 750 fëmijësh përfituese nga masat dhe ndërhyrjet e planifikuara. Plani synon të përmirësojë infrastrukturën, cilësinë e mësimdhënies dhe përkujdesjen sociale, duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë për të gjithë fëmijët.</p> <p><b>II. Objektivat Kryesore dhe Veprimtaritë</b></p> <p><b>1. Përmirësimi i kushteve infrastrukturore dhe shërbimeve bazë në institucionet arsimore</b></p> <p>Për të garantuar një mjedis të përshtatshëm për mësimdhënie dhe zhvillim të fëmijëve, janë parashikuar ndërhyrje vjetore në infrastrukturën ekzistuese dhe shërbimet mbështetëse, përfshirë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës (objektet shkollore dhe parashkollore)</li> <li>• Garantimi i kushteve higjieno-sanitare në të gjitha institucionet</li> <li>• Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional</li> <li>• Furnizimi me kancelari dhe mjete didaktike</li> <li>• Ofrimi i ushqimit në mensat e kopshteve dhe kryerja e shërbimeve të dezinfektimit</li> </ul> <p>Këto masa do të zbatohen çdo vit gjatë periudhës 2026–2028.</p> <p><b>2. Mbështetje sociale dhe zhvillim profesional për mësuesit dhe nxënësit</b> Ky objektiv synon të forcojë përfshirjen sociale dhe barazinë në arsim, si dhe të rrisë cilësinë e shërbimit edukativ. Veprimtaritë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetje për nxënësit nga familjet në nevojë</li> <li>• Nxitja dhe shpërblimi i nxënësve me rezultate të larta</li> <li>• Zhvillimi profesional i stafit mësues dhe përmirësimi i kurrikulës</li> <li>• Funksionalizimi i strukturave këshilluese në shkolla dhe kopshte (këshillat e prindërve, bordet shkollore, komisionet e shëndetit dhe sigurisë)</li> </ul> <p><b>3. Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës përmes aktiviteteve jashtëmësimore</b> Aktivitete të shumta jashtëkurrikulare do të organizohen për të nxitur shëndetin, kreativitetin dhe ndërgjegjësimin qytetar të fëmijët. Këto përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Java Evropiane e Sportit dhe Java Olimpikë</li> <li>• Ditë ndërkombëtare si: Dita e të Drejtave të Fëmijëve, Dita kundër Bullizmit, Dita e Librit, Dita e Ujit, Dita e Alfabetit, etj.</li> <li>• Aktivitetet do të zhvillohen gjatë vitit shkollor në bashkëpunim me institucionet vendore dhe partnerë të fushës së edukimit.</li> </ul>
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të Drejtoreshes së shërbimeve sociale, në bashki: <a href="mailto:irenabello@gmail.com">irenabello@gmail.com</a> dhe keshillit bashkiak <a href="mailto:keshillibashkiakdelvine@gmail.com">keshillibashkiakdelvine@gmail.com</a> BRENDA DATËS 15.08.2025</p>
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli dhe administrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë dhe Bashkia Delvinë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit ose personave përgjegjës në bashki të një Përmbledhjeje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhjeje;</li> <li>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhjeje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Arsimit, Kultures dhe Sporteve, të Ekonomisë dhe Financës dhe çdo këshilltari të bashkisë;</li> </ol>

	<ol style="list-style-type: none"><li>3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve të cdo rekomandimi dhe opinionit.</li><li>4. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit.</li><li>5. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar.</li><li>6. Monitorimi i zbatimit të tij.</li></ol>
Data e publikimit	31.07.2025